

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Debati për pagat/ Magjistratët refuzojnë ftesën e Ramës: Do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/18/gjyqtaret-dhe-prokuroret-kunder-ligjit-per-pagat-do-ti-drejttojemi-gjykates-kushtetuese/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:32:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:30:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4d0e588215c40345f08b22b035691e62fc6a936a49aec73d50d67df91045db22
TEKSTI	e2427bdb5fb97d3ccb8fa0c7b197ade87db252350f2bb7f8569ce05e93f99625
PAMJA	facfb8873d6081746e49fd180b2ed80b6cd53004afd347e465c0669732d6c8f9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ad5e7a622456e20b52cefd6c97fcf223f31ebf469ef8bd329527b240d31cfc0
E MËPARSHMJA	a1ac062f1c3f3c116ba7ed8feeee9de07b887b459dbd044f1566d3ce50161eb7
RRËNJA MERKLE	9c628a07075feceb8104ab280f983adfb76a5f01a86c5eb5ef058772798de17b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ad5e7a622456e20b52cefd6c97fcf223f31ebf469ef8bd329527b240d31cfc0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Debati për pagat/ Magjistratët refuzojnë ftesën e Ramës: Do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese

15:30 : 18/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë kanë reaguar kundër procedurës së ndjekur për miratimin e ndryshimeve në ligjin për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në një reagim të përbashkët, shoqatat e magjistratëve kanë refuzuar **ftesën e Ramës** për bisedë, ndërsa deklarojnë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

Sipas tyre, procedura parlamentare për miratimin e projektligjit është shoqëruar me shkelje të kërkesave kushtetuese dhe përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës.

"Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi. Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magjistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese",- thuhet ndër të tjera në njoftim.

Reagimi i plotë:

Lexo edhe:

[Debati për pagat/ Rama thirrje gjyqësorit: Ejani të flasim!](#)[Ankohet për pagat e gjyqtarëve/ Rama, kryeministri me rrogën më të lartë në rajon \(shifrat\)](#)

Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së

TË GJITHA



Policia spanjolle nis operacionet për të larguar emigrantët nga plazhet e Ceutës

15:53 : 18/09/2026



Zjarr në zonën e Sektorit Rinia në Durrës

15:39 : 18/09/2026



Debati për pagat/ Magjistratët refuzojnë ftesën e Ramës: Do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese

15:30 : 18/09/2026



Meta: Rama delirant! Nuk njeh Gjykatën Kushtetuese as parimin e shtetit të së drejtës

15:19 : 18/09/2026



Deputeti i Zogut/ Po mohohen pronat e dr. Simonidhit? Çfarë fshihet pas arrestimit të nipit, Kastriot Hasko

15:15 : 18/09/2026



Bashkëshortja u arrestua për përvetësimin e 69 mln lekëve, Fetah Mataj emërohet përgjegjës në Bashkinë Durrës

15:10 : 18/09/2026



"Fati politik i Ballukut është mbyllur"/ Këlliçi: SPAK do t'i drejtohet sërish Kuvendit këto ditë

14:48 : 18/09/2026

Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë shprehin vendosmërinë e tyre për të vijuar ndjekjen e procesit kushtetues lidhur me pagat e magistratëve.

Me keqardhje kemi ndjekur procedurën parlamentare për miratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”. Që në fillim, kjo procedurë është karakterizuar, në vlerësimin tonë, nga shkelje të kërkesave kushtetuese, duke nisur nga miratimi i projektligjit përtej afatit kushtetues, mungesa e një analize financiare nga Këshilli i Ministrave, mungesa e konsultimit efektiv dhe dëgjimi tërësisht formal i grupeve të interesit dhe, në fund, hyrja e menjëhershme në fuqi e ligjit.

Shoqatat tona mbeten të palëkundura në qëndrimin e tyre për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të magistratëve, të cilat janë cenuar haptazi nga ligji i miratuar në orët e mesnatës. Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Shoqatat tona shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Kemi besimin e plotë se do të jetë pikërisht procesi kushtetues ai që do të sqarojë çështjet e ngritura dhe do të hedhë poshtë përpjekjet për të diskredituar magistratët dhe kërkesat e tyre legjitime.

Theksojmë edhe një herë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Ajo lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës.

Për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe vlerave kushtetuese, shoqatat tona mbeten të palëkundura dhe do të përdorin çdo mjet ligjor që Kushtetuta dhe ligji u vënë në dispozicion.

Etiketa: Gjykata Kushtetuese magistratë paga

Lajme të lidhura



Debati për pagat/ Rama thirrje gjyqësorit: Ejani të flasim!

12:12 : 18/09/2026



Ankohen për pagat e gjyqtarëve/ Rama, kryeministri me rrogën më të lartë në rajon (shifrat)

11:38 : 18/09/2026



Mali i Zi shpall modelin e ri të pagave, nga janari 2027 rroga minimale deri në 1400 euro

11:20 : 18/09/2026



Miratohet projektligji i PS-së për pagat e magistratëve

08:33 : 18/09/2026



SPAK nis hetim për çështjen e pagave të magistratëve

19:17 : 17/09/2026



Bardhi – mazhorancës: Vendimet e Kushtetueses le të rregullojnë kur s'ju intereson

11:01 : 17/09/2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.